

L I G J
Nr.9507, datë 3.4.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9075, DATË 29.5.2003 “PËR MIRATIMIN E
KRITEREVE DHE TERMAVE KRYESORË TË ZGJIDHJES SË BORXHIT TË JASHTËM
TË TRASHËGUAR, TË PAPAGUAR TË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9075, datë 29.5.2003 “Për miratimin e kriterëve dhe termave kryesorë të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Shkronja "b" e pikës II të nenit 1 ndryshohet si më poshtë:

"b) për borxhin e jashtëm të trashëguar ndaj kreditorëve të tjerë, që nuk janë anëtarë të Klubit të Parisit, përdoret të paktën njëri nga kriteret e mëposhtme:".

Neni 2

Fjalja e dytë e pikës III "Afati i përfundimit të marrëveshjeve" të nenit 1 ndryshohet si më poshtë:

“Marrëveshjet dypalëshe për zgjidhjen e borxhit të jashtëm të përfundohen deri më 31.12.2007.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4841, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu